

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
DEGA VENDORE TIRANE  
NOTERE PUBLIKE AJTENA ZELA  
NR. 2166 REP.  
NR. 1088/1 KOL.



**KONTRATE DHURIMI**  
**PASURI E LUAJTSHME (KUOTA)**  
**(KUOTAT E KAPITALIT TE SHOQERISE "AL-SHOES" SHPK)**

Ne Kruje, sot me date 15.11.2019 (dymije e nentembedhjete), perpara meje Notere Publike Ajtena Zela, notere prane Dhomes se Notereve Tirane, me zyre noteriale ne Lagjian nr 1 Kruje, u paraqiten personalisht palet e meposhtme kontraktuese te cilet kerkuan redaktimin e kesaj Kontrate Dhurimi Pasuri e Luajtshme Kuotash si me poshte vijon:

1. **Z. Arjan Hoxha**, shtetas shqiptar, me atesi Gëzim, lindur me 07.08.1982 ne Kruje dhe banues ne Kruje, mbajtes i dokumentit te identifikimit Leternjoftim ID me nr. 033375663 dhe Nr. Personal I 20807056 O, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar ;
2. **Z. Zamir Shehu**, shtetas shqiptar, me atesi Tasim, lindur me 10.05.1972, ne Ceren dhe banues ne Arrameras Fushe-Kruje, me status beqar, mbajtes i dokumentit te identifikimit Leternjoftim ID me nr. 034266722 dhe Nr. Personal H 20510095 Q, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me poshte referuar si **"PRANUES I DHURIMIT/ PALA PRANUESE E DHURIMIT"**;

Secilit prej Paleve te lartpermendura do t'i referohemi si "Pale", dhe bashkarisht do t'u referohemi si "Palet". Palet e lartpermendura per identitetin e te cileve u sigurova nepermjet dokumenteve te paraqitura prej tyre , sipas Vendimit te Asamblese se Shoqerise AL-SHOES shpk dhe sipas Ekstrakit te nxjerre nga QKB, ka tagra te plota per te vepruar dhe per te hyre ne kete Kontrate . Te dyja palet, personalisht me bene me dije, duke ushtruar vullnetin e tyre te lire, qe duan te lidhin kete Kontrate Dhurimi Pasuri e Luajtshme Kuotash ("Kontrate Dhurimi Kuotash"), sipas kushteve dhe termave te vendosura si me poshte vijon:

**TE PERGJITHSHME**

- A. Z. Arjan Hoxha eshte zoterues i 1 (nje) kuote, ne vleren prej 100.000 (njqind mije ) LEK ne Shoqerine **"AL-SHOES" shpk, (me poshte referuar si "SHOQERIA")**. Shoqeria eshte rregjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me date 04.03.2019, mbajttese e NIPT L93904201B dhe seli ne Durres, Kruje, Kameras, rruga nacionale, ndertese private, 1 kateshe, zonaka kadastrale 1921, me nr pasurie 1.
- B. Objekti i saj konsiston ne Qepjen e faqeve te kepuceve te perfunduara, me lenden e pare te sjelle nga porositesi. Fason. Import-eksport te makinerive te ndryshme per procesin e prodhimit
- C. Kapitali i Shoqerise eshte 100.000 (nje qind mije) LEKE.
- D. Pala Dhuruese, Z. Arjan Hoxha me vullnetin e saj te lire e te plote dhe te pavesuar ka vendosur te dhuroje te gjithë kuoten qe zoteron ne kapitalin e Shoqerise "AL-SHOES" SHPK, ne favor te Pranuesit te Dhurimit Z. Zamir Shehu.

- E. Dhuruesi deshiron t'i dhurojn Pranuesit te Dhurimit kuotat e tij, dhe Pranuesi i Dhurimit deshiron te pranoje pa ndonje kundershperblim kete dhurate, sipas kushteve dhe termave te vendosura ne kete kontrate.
- F. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Dhurimi Pasuri e Luajtshme ( Kuotash) dhe depozitimin e saj prane Qendres Kombetare te Biznesit, Pala Pranuese e Dhurimit, Z. Zamir Shehu do te jete ortak i vetem i shoqerise "AL-SHOES" shpk, duke qene zoterues i 100 % te kapitalit te Shoqerise, e cila perkon me 1 (nje) kuote, e barasvleshme me vleren ne kontribut monetar ne kapitalin e Shoqerise prej 100.000 Lek ( nje qind mije leke).

## NENI 1 OBJEKTI

1.1 Ne perputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara ne kete kontrate, Pala Dhuruese, pa kundershperblim, nepermjet dhurimit te kuotave te tyre te zoteruara ne shoqeri kalojne te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin prej pronesisë te shoqerise "AL-SHOES" SHPK, si dhe te drejtat e tjera te lidhura me kete pjesemarrje ne drejtim te Pranuesit te Dhurimit, duke i bere te ditur ketij te fundit cdo dhe te gjitha detyrimet, apo kufizimet qe lidhen me kete dhurim kuote, duke garantuar plotesisht titullin e pronesisë te pa renduar me barre.

## NENI 2 KALIMI I PRONESISE SE LIGJSHME MBI KUOTAT

2.1 Kalimi i pronesisë se ligjshme mbi kuoten nga Pala Dhuruese ne favor te Pales Pranuese te Dhurimit do te kryhet pa kundershperblim, menjehere me nenshkrimin e kesaj Kontrate Dhurimi nga palet dhe regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Dhurimi kuotash te gjitha detyrimet dhe te drejtat ne lidhje me zoterimin e kuotave dhe pjesemarrjes ne te do te kalojne ne emer te Pales Pranuese te Dhurimit, **pra ne favor te Z. Zamir Shehu.** Gjithashtu me nenshkrimin e kesaj Kontrate Dhurimi, Pala Dhuruese, Zarjan Hoxha zhvishet teresisht nga pronesia dhe te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin prej mbajtjes se kuotave, karshi entiteteve Private dhe/ose entiteteve Publike qe operojne ne Shqiperi.

2.2 Pala Pranuese e Dhurimit deklarone se do te kryeje te gjitha regjistrimet e nevojshme te detyrueshme dhe publikimin e kesaj Kontrate sipas percaktimeve te nenit 43 dhe 44 te ligjit "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" nr. 9723, date 03.05.2007, i ndryshuar.

## NENI 3 GARANCITE

Pala Dhuruese garanton Pranuesin e Dhurimit, ne lidhje me kuotat qe secili prej tyre zoterone ne shoqerine "AL-SHOES" shpk:

3.1. Se Arjan Hoxha eshte pronar i vetem i kuotes se dhuruar karshi Pranuesit te Dhurimit dhe se nuk ekzistojne te drejta te parablerjes, te dhurimit, te marrjes ose te **opcionit te pretendimit nga ndonje pale e trete ne lidhje me kuotat e dhuruar perkatesisht nga Z. Arjan Hoxha;**

3.2. Se e drejta per perfitimin e dividendit mbi kuoten e fituar ne shoqerine do te mund te ushtrohet rregullisht;

3.3. Shoqeria nuk eshte pjesemarrrese direkte ose indirekte ne shoqeri te tjera dhe as nuk eshte e detyruar te bleje apo te mbaje pjesemarrje te tilla.



3.4. Te gjitha te mirat ekonomike te perdorura nga shoqeria, te cilat jane te nevojshme ose te dobishme per aktivitetin ekonomik te shoqerise dhe per vazhdimin e pakufizuar te tyre pas dites se lidhjes se Kontrates se Dhurimit se Kuotes veçanerisht objektet pasurore, jane ne pronen e vetme te shoqerise.

#### NENI 4

#### REGJISTRIMI

4.1. Regjistrimi i kalimit te kuotave nga Pala Dhuruese tek Pala Pranuese e Dhurimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit do te kryhet menjehere pas nenshkrimit te kontrates nga Pala Dhuruese dhe Pala Pranuese e Dhurimit. Kjo kontratet duhet te depozitohet brenda 30 diteve prane Qendres Kombetare te Biznesit, me qellim reflektimin e ndryshimeve te struktures se ortakerise se Shoqerise prane ketij regjistri.

#### NENI 5

#### LIGJI I ZBATUESHEM

5.1. Kjo kontrate rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar me 129/2014, neni 705 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, Ligji "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" si dhe perkatesisht dispozitat e aktit te themelimit dhe Statutit te Shoqerise.

#### NENI 6

#### ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

6.1. Palet do te perpiqen te zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kesaj kontrate, ne te kundert juridiksioni kompetent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor te Krujes.

#### NENI 7

#### TE NDRYSHME

7.1 Nenet e pergjithshme jane pjese e pandare e kesaj kontrate.

7.2 Kjo kontrate mund te ndryshoje vetem me pelqimin e te dyja paleve duke respektuar formen shkresore te noterizuar.

Per sa me siper, ky akt hartohet nga une noterja ne 4 (kater) ekzemplare me vlere te njejte ligjore. Palet ne perputhje me vullnetin e tyre te plote dhe te pavesuar, nenshkruajne perpara meje Noteres. Une Noterja, pasi verifikova identitetin e paleve te mesiperme nepermjet dokumentave te paraqitur si me siper vertetoj nenshkrimin e tyre, ne perputhje te plote me Ligjin nr. 110.2018, date 20.12.2018 "Per Noterine".

Ne zbatim te ligjit 9887, date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave Personale" i ndryshuar, une Noterja deklaroj se do te ruaj dhe perpunoj te dhenat personale te subjekteve te kesaj kontrate, ne menyre te drejte dhe te ligjshme.

#### PALET

DHURUESI/PALA DHURUESE

ARLAN-HOXHA

/PALA PRANUESE E DHURIMIT



ZAMIR

NOTERJA  
Ajkëna Zela